



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ministri

Nr. 2457 Prot.

Tiranë, më 09.03, 2017

RREGULLORE E BRENDSHME

E

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit të brendshëm dhe të marrëdhënieve ndërmjet niveleve të ndryshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (në vijim “Ministria”).

Neni 2

Misioni dhe veprimtaria

1. Ministria ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor, zhvillimin perspektiv të arsimit, respektimin e interesave të individit, komunitetit e të shoqërisë dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme për t’u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe evropiane, krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies e të shërbimeve. Ministria harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, integritit kulturor, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e sportit shqiptar.
2. Ministria ushtron veprimtarinë e saj vetëm ose në bashkëpunim me ministri të tjera, sipas delegimit që i bën Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin përkatës, në këto fusha përgjegjësie shtetërore:
 - Sektorin e edukimit parauniversitar;
 - Sektorin e arsimit të lartë;
 - Sektorin e zhvillimit të arsimit jopublik;
 - Sektorin e zhvillimit të sportit.

Neni 3

Strukturat e Ministrisë

1. Ministria funksionon sipas strukturës të miratuar me urdhër të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.

